



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
ADMINISTRATORI

Nr. 1294 Prot.

Tiranë, më 08/05/2024

**NJOFTIM
PËR APLIKIM PËR EKSPERT TË JASHTËM INXHINIER NDËRTIMI**

(angazhim me kontratë shërbimi)

Universiteti i Sporteve të Tiranës, në zbatim të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në kuadër të hartimit të Detyrës së Projektimit (Termave të Referencës) për objektin “Rikonstruksion i sistemit të kondicionimit të bibliotekës dhe godinës 4–katëshe” të Autoritetit Kontraktor, Universiteti i Sporteve të Tiranës, për të qenë pjesë e Grupit të Punës, kërkon 1 (një) Inxhinier të fushës së Inxhinierisë së Ndërtimit (profil inxhinier ndërtimi ose inxhinier strukturist), si ekspert i jashtëm (të angazhuar me kontratë shërbimi).

Eksperti duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të ketë përfunduar studimet universitare ose pasuniversitare sipas fushës së kërkuar, (Inxhinier Ndërtimi ose Inxhinier Strukturist).
2. Të ketë eksperiencë pune mbi 10 (dhjetë) vite për hartim Detyrash Projektimi (Terma Reference).
3. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë brenda datës 13.05.2024, në zyrën e Protokollit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për aplikim;
- Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
- Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit).
- Kopje origjinale ose noterizuar e licencës së projektimit në fushën e ndërtimeve, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
- Vetëdeklarim mbi parandalimin e konfliktit të interesit.

Mënyra e vlerësimit: Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe sistem pikëzimi.

ADMINISTRATORI
Haxhirota Sulaj

